



Federata Aeronautike e Kosovës

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "Bordi i FAK") në mbledhjen së vet të datës 09.11.2017 miratoi këtë rregullore:

RREGULLORE 05/2017

RREGULLORE PËR DEFINIMIN E KRITEREVE PËR SHPALLJEN E SPORTISTIT TË VITIT

Me qëllim të rregullimit të procesit të vlerësimit dhe definimit të kushteve garuese e kritereve matëse për sukseset individuale të cilët shërbejnë për rankim të pilotëve në garën për titullin "Sportist i Vitit", kryesia e FAK nxjerrë këtë rregullore

Neni 1.

Dispozitat e përgjithshme

- 1.1 Shpallja e sportistit të vitit bëhet një herë në vit, zakonisht gjatë muajit Dhjetor
- 1.2 Për pilotin e shpallur "Sportist i vitit", përveq titullit, në bazë të mundësive financiare të FAK, rekomandohet që FAK të ndajë edhe një dhuratë modeste
- 1.3 Titulli "Sportist i vitit" dhe shpërblimi i dorëzohen pilotit nga ana e Kryetarit të FAK ose nga anëtari më i vjetër i bordit të FAK
- 1.4 Sportisti i vitit shpallet piloti që ka akumuluar më së shumti pikë (sipas kriteve të pikësimit të përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje) për aktivitetet sportive të kualifikuara për pikësim që janë regjistruar në periudhën prej shpalljes së fundit të "Sportistit të vitit" deri në ditën kur bëhet kalkulimi i pikëve për titullin e vitit aktual.

Neni 2.

Kualifikimi për t'u regjistruar në listën e sportistëve konkurent

- 2.1 Kriteri minimal që një sportist të kualifikohet si konkurrent për titullin "sportist i vitit" është që ai/ajo të jetë pilotë i/e licensuar nga Autoriteti Rregullativ i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AAC).



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 3.

Pikësimi dhe kalkulimi

3.1. Aktivitetet që kualifikohen për pikësim si dhe vlera e pikëve për pjesëmarrje dhe të arritura në këto aktivitete është:

- Pjesëmarrja në gara kombëtare/ndërkombëtare FAI 1: **20 pikë**
- Pjesëmarrja në gara kombëtare/ndërkombëtare FAI 2: **10 pikë**
- Rankim në vendin e parë në mesin e pilotëve Kosovar në gara kombëtare/ndërkombëtare FAI 1/2: **30 pikë**
- Rankim në vendin e dytë në mesin e pilotëve Kosovar në gara kombëtare/ndërkombëtare FAI 1/2: **20 pikë**
- Rankim në vendin e tretë në mesin e pilotëve Kosovar në gara kombëtare/ndërkombëtare FAI 1/2: **10 pikë**
- Arrtije në rezultat, rankim në vendin e parë, vendin e dytë ose vendin e tretë në mesin e të gjithë pilotëve pjesëmarrës në garë ndërkombëtare FAI 1/2: **50 pikë**
- Arrtije në rezultat, shënim i ndonjë rekordi vendor sipas rregullores "RREGULLORJA 03/2017": **30 pikë**

3.2. Cdo candidate e gjinisë femërore merr në total **50 pikë** shtesë, si bonus

3.3. Në rastin kur dy ose më shumë kandidatë kanë numër të njëjtë të pikëve, rankimi bëhet në bazë të renditjes alfabetike, Emri Mbiemri.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 4. Hyrja në fuqi

4.1. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga bordi i FAK.

4.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj.

Prishtinë, 09.11.2017

Shkelqim Krasniqi
Kryetar i bordit të FAK